

URDHËR
Nr. 495, datë 27.10.2022

**PËR NDALIMIN E PESHKIMIT NË LIQENIN E OHRIT DHE GRUMBULLIMIN
E VEZËVE TË KORANIT PËR INKUBIM**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr. 64, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

Ndalimin e peshkimit me çfarëdolloj mjeti dhe metode gjuetie, si dhe ndalimin e mbajtjes në bord, tranzitimin në barkë dhe zbarkimin e qëllimtë të belushkës (*Salmothymus ohridanus*), në liqenin e Ohrit, prej datës 1.11.2022 deri më datë 1.3.2023.

2. Ndalimin e peshkimit me çfarëdolloj mjeti dhe metode gjuetie, si dhe ndalimin e mbajtjes në bord, tranzitimin në barkë dhe zbarkimin e qëllimtë të të gjitha llojeve të peshqve në liqenin e Ohrit, prej datës 1.12.2022 deri më datë 1.3.2023, me përjashtim të tratave të zallit (vlagë) për gjuetinë e cironkës (alburnus alburnus alborella), sipas zonave bregliqenore të përcaktuara nga Organizata e Menaxhimit të Peshkimit (OMP) Pogradec.

3. Çdo mjet gjuetie peshku i kapur nga organet e monitorimit dhe kontrollit gjatë kohës së ndalimit të gjuetisë së peshkut, të sekuestrohet.

4. Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës (DSHPA), të koordinojë veprimtarinë organizative, teknike dhe financiare me Qendrën e Prodhimit të Rasateve të Koranit në fshatin Lin të Pogradecit, për gatishmërinë e marrjes së vezëve të koranit (salmo letnica), shtrimit dhe trajtimit të tyre për inkubim.

5. Për periudhën prej 1.1.2023 deri më 1.3.2023, të lejohet vetëm peshkimi i riprodhuesve të koranit për qëllime të grumbullimit të vezëve deri në 200 kg, të cilat do të shtrohen për inkubim në impiantet e Qendrës së Prodhimit të Rasateve të Koranit, në fshatin Lin të Pogradecit.

6. Shpenzimet e pagesës së materialit biologjik (vezëve), karburantit që shpenzohet për grumbullimin dhe transportimin e vezëve të koranit dhe shpenzimet e tjera që kanë të bëjnë me këtë aktivitet do të mbulohen nga buxheti i planifikuar i DSHPA-së.

7. Veprimtaria e grumbullimit të vezëve, të kryhet e organizuar nën drejtimin e DSHPA-së, në varësi të së cilës është Sektori i Kontrollit dhe Monitorimit të Peshkimit, Qendra e Prodhimit të Rasateve të Koranit në fshatin Lin të Pogradecit, të cilat në bashkëpunim me OMP-në Pogradec, të përcaktojnë dhe aktivizojnë për këtë qëllim 60 peshkatarë me përvojë, anëtarë të kësaj OMP-je.

8. DSHPA-ja, nëpërmjet Qendrës së Prodhimit të Rasateve të Koranit në fshatin Lin të Pogradecit, të lidhë kontratë me OMP-në Pogradec, për mbledhjen dhe dorëzimin e vezëve të koranit, të ndara sipas zonave specifike buzë liqenit.

9. OMP-ja Pogradec dhe DSHPA-ja në bashkërendim me Sektorin e Politikave të Peshkimit dhe Akuakulturës, në Drejtorinë e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, të hartojnë një plan-veprimi të detajuar dhe të miratuar prej tyre.

10. Ngarkohen Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Qendra e Prodhimit të Rasateve të Koranit në fshatin Lin të Pogradecit, si dhe Organizata e Menaxhimit të Peshkimit Pogradec, të bashkëpunojnë me strukturat e qeverisjes vendore Pogradec, Komisariatit e Policisë, Policinë Tatimore, Drejtorinë Rajonale të AKU-së Korçë, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca